

Republika e Kosovës - Republika Kosova  
 Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica  
 Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative  
 Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 011/07-3597  
 Data/Datum 09-02-2020

Gjakovë, Djakovica - Gjakova

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
 OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**Kuvendi i Komunës së Gjakovës**  
 01 Nr. \_\_\_\_\_/2020  
 Datë: 30.01.2020

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2020 pas diskutimit lidhur me pikën e 11 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale-Parkingjeve, e miratoi këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale. Parkingjeve me nr. të parcelave: P-70705029-05831-1 Z.K Qytet, P-70705029-05826-1 Z.K Qytet, P-70705029-03495-69, ZK Qytet dhe P-70705029-05833-2, Z.K Qytet , P-70705029-05829-2, Z.K Qytet, P-70705029-05765-1 Z.K Qytet, P-70705029-05765-4 Z.K. Qytet, të cilat janë në Pronësi të Komunës së Gjakovës, me këtë përbërje :

1. z. Shkumbim Kastrati, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
2. z. Flamur Fetahaj, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
3. znj. Dafina Syla, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës .
4. znj. Valentina Alijaj, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës .
5. znj. Delvina Dylazeka, përfaqësues i sektorit jo qeveritar .

2. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që ti zhvilloj procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së paluajtshme Komunale vetëm për pronat e cekura në pikën 1 të këtij vendimi, për të cilat është nxjerrë vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës .

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

4. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Anëtarëve të Komisioni .
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës .
- Arkivit .

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës  
 Anton Shala